



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:218892

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06504527

**2024:302372**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.N. të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.1739-9/19, të dt. 27.09.2019, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor publik me datë 21.11.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, përfaqësuesit të palës së dëmtuar L.S., dëshmitarit H.B. dhe të akuzuarit, me dt. 22.11. 2024 nxjerr këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.N.** nga i ati A., e ëma M., e gjinisë Sh., i lindur me dt..... në Ferizaj, me vendbanim në fsh..... K Shtime, me numër personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punëtor teknik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë për vepra të ndryshme penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

**Në kuptim të nenit 362 par. 1 nën par 1.1 të KPPK-së.**

## **REFUZOHET AKUZA**

Sepse me 21 Gusht 2019, rreth orës 15:00, në vendin e quajtur “.....”, e cila gjendet në Rajonin Ekonomiko Pyjor Neredime-Jezerc, me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë një (1) lis të llojit ahut me diametër 68 cm, me lartësi boniteti III, me vëllim të përgjithshëm 4.14 m<sup>3</sup>, është takuar në vendngjarje dhe ka qenë me traktor me rimorkio, dëmi i shkaktuar është në shumë prej 558.90 €.

- Me çka do të kryente veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Meqë Prokurori i shtetit, në fund të shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarit A.N. për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr. PP/II.nr. 1934-2/19, të dt. 21.10.2019, e ka akuzuar të akuzuarin për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar sipas aktakuzës pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore ka nxjerrur Aktgjykim dënues P.nr. 10150/19 të dt. 30.10.2023 dhe të pandehurin e ka shpallë fajtor dhe ka dënuar me dënim në të holla në shumë prej 300 €. I pandehuri në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kundër këtij aktgjykimi, ndërsa Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të pandehurit me aktvendimin e saj PA1. Nr. 106/2024 të dt. 18.10.2024, ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe lëndën e ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje dhe ka udhëzuar gjykatën që në rigjykim të obligojë të pandehurin që të përkthej nga gjuha Gjermane në gjuhë Shqipe dokumentin me të cilin pretendon se e argumenton se i njëjti nuk ka qenë në Kosovë gjatë kohës së veprës penale.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze dhe udhëzimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës të dhëna në Aktvendimin e saj PA1.nr.106/2024 të dt. 18.tetor 2024, caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 21.11.2024, në të cilin shqyrtim gjyqësor kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit, përfaqësuesi i palës së dëmtuar, dëshmitarit dhe i akuzuari, i akuzuari gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale që i është ngarkuar në aktakuzë duke theksuar se nuk është kryes i veprës penale, pasi që në kohën kur po më ngarkon akuza se kam kryer veprën penale vjedhje pylli, unë kam qenë në vuajtje të dënimit me burg në Gjermani dhe atë prej dt. 14.01.2019 gjerë me dt.27.12.2021 dhe si dëshmi për këtë gjykatës ka sjellë vërtetimin në gjuhë Gjermane të lëshuar nga Institucioni korrektues Bernau të dt.27.02.2024, të përkthyer edhe në gjuhë shqipe nga përkthyesi dhe Interpreti gjyqësor i licencuar nga KGJK-së. Prokurori i shtetit në përfundim të shqyrtimit gjyqësor pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës, e në veçanti të vërtetimit me të cilin pala ka dëshmuar se ka qenë në vuajtje të dënimit në shtetin e Gjermanisë, është tërhequr nga akuza dhe ndjekja penale kundër të akuzuarit, për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, duke deklaruar se nga provave të administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer vepër penale.

Pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza dhe ndjekja penale ndaj të akuzuarit, gjykata në bazë të neni 362 par. 1 nën par 1.1 të KPPK-së, refuzoi akuzën siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale, është i bazuar në nenin 454 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**2024:302372, me datë 22 11.2024**

**Zyrtare ligjore,**  
**Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 dite, nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.